

# Ambasadorja franceze: Gjykata Kushtetuese duhet të ngrihet sa më shpejt

Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Cristina Vasak bëri thirrje që Gjykata Kushtetuese të ngrihet sa më parë. Vasak tha se është më rëndësi ringritja e Kushtetueses sepse sipas saj janë disa çështje shumë të rëndësishme që presin përgjigje.

“Gjykata Kushtetuese duhet të ngrihet sa më shpejt. Unë e kam thënë këtë shumë herë këtu në Pogradec, Tiranë. Të gjithë personalitetet e politikës, pavarësisht ngjyrave janë të ndërgjegjshëm për këtë. Është e domosdoshme që Gjykata Kushtetuese të ndërtohet dhe të fillojë të punojë sepse ka një seri problemesh të rëndësishme që janë përpara saj. Edhe Gjykata e Lartë është shumë e rëndësishme të fillojë të punojë, por kjo është në një fazë më të avancuar se Gjykata Kushtetuese.” tha Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Cristina Vasak nga Korça, ku shoqëroi një grup deputetësh francezë.

Sa i përket Këshillit Politik, Vasak tha se puna duhet të vazhdojë. “Është një gjë e mirë që ky Këshill Politik ekziston dhe është mirë që të vazhdojë punën e tij me një inteligjencë të mirë. Ata e dinë si duhet të funksionojnë, dhe nuk ka pse t’ua thotë këtë një diplomat i huaj.” tha ajo.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i hapi një ditë më parë rrugën zgjedhjes së anëtarit të pestë të Gjykatës Kushtetuese. KED vendosi që nga 4 kandidaturat vetëm Altin Binaj të kalojë klasën dhe të vijojë më tej kandidimin për të plotësuar vakancën e shpallur nga presidenti Ilir Meta në 22 nëntor 2019. Binaj, aktualisht prokuror dhe drejtues pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë, pritet të propozohet në vijim për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, pasi ai ka kaluar me sukses edhe procesin e Vetingut.